



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d) e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1 pika d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr.110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.06.2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet subvencionimi i Fondacionit “Robin Haxhi Krasniqi” për organizimin e ndeshjes së boksit profesionist ndërkombëtar.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, shuma e mjeteve të ndara janë në vlerë prej 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro), të cilat do të sigurohen nga kategoria e subvencioneve të Administratës me kod ekonomik 16306/200.
3. Qëllimi i këtij Vendimi është, ofrimi i mbështetjes financiare për mbulimin e shpenzimeve për organizimin dhe mbarëvajtjen e ndeshjes së boksit profesionist ndërkombëtar, i cili do të mbahet më 05 Gusht 2023, në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë.
4. Sipas pikës 2 dhe 3 të këtij Vendimi, Fondacioni “Robin Haxhi Krasniqi” do të dorëzoj Raport financiar përmes të cilit do të pasqyrohen shpenzimet e mbuluara nga ky subvencionim.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-422/01-134181/23, më 29.06.2023

KRYESUES I MBLEDHJES SË KUVENDIT
AJET BRAJSHORI